



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS**

Nr. 46 prot.

Durrës, më 13.11.2020

**VENDIM**

**Për vazhdimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë**

Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i mbledhur sot online, më datë 13.11.2020, bazuar në nenet 27, 28 e 37/ç të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi

**KONSTATOI:**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rezultuar se disa prej gjyqtarëve dhe punonjësve të administratës gjyqësore kanë rezultuar të infektuar nga COVID – 19. Gjendur në këtë situatë të jashtëzakonshme pandemie, Këshilli i Gjykatës, me vendimin nr. 45, datë 04.11.2020, vendosi pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës nga data 05.11.2020-16.11.2020.

Duke qenë se gjatë kësaj periudhe ka pasur raste të shtuara të punonjësve që kanë shfaqur simptoma të infektimit nga COVID – 19, në funksion të reduktimit të transmetimit të virusit dhe zbatimit me rigorozitet të protokolleve të përcaktuara për situatën COVID – 19, Këshillimi i Gjykatës, bazuar në: nenin 38 të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020 të Këshillit të Ministrave; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; Udhëzimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 146 datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata” ; vendimin Nr. 45, datë 04.11.2020 të Këshillit të Gjykatës “Për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”,

**VENDOSI:**

1. Vazhdimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga data **16.11.2020-20.11.2020**, me përjashtim të çështjeve me karakter urgjent, sipas të gjitha parashikimeve të përcaktuara me vendimin Nr. 45, datë 04.11.2020 “Për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Një kopje e vendimit t’u shpërndahet gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, një kopje të afishohet për njoftim në ambientet dhe faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës si dhe një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet Këshillit të Lartë Gjyqësor

dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, IEVP Durrës si dhe Drejtorisë së Burgjeve.


## KËSHILLI I GJYKATËS

**ZËVENDËSKRYETARI**

**MARKELIAN KOÇA**

**Në mungesë dhe me autorizim**

**EDNA KAJA**



**KANCELARE**  
**VIOLA KONDO**

